

**AKTI I THEMELIMIT
DHE
STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJESI TË KUFIZUAR**
“ZACHE TRANS”

Sot, më datë, **05.12.2024**, bazuar në ligjin Nr. 9901 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar dhe në ligjin Nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar, themeluesi:

Mensur Zachev, atësia Myrteza, amësia Nabije, shtetas maqedonas, i datëlindjes 21.12.1961, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pajisur me letërnjoftimin nr. M0820958 dhe nr. personal 2112961430003, në cilësinë e ortakut të vetëm, vendosi të krijojë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, **“ZACHE TRANS”**, shpall statutin e kësaj shoqërie tregtare si më poshtë vijon:

KREU I

**EMRI I SHOQËRISË, SELIA, KOHËZGJATJA, OBJEKTI, VULA, LOGO E
SHOQËRISË DHE LLOGARITË BANKARE**

**NENI 1
EMRI I SHOQËRISË**

1.1. Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **“ZACHE TRANS”** (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

**NENI 2
SELIA**

2.1. Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: **Ndërtesë, Shkalla -1, ndoshur në ZK 8552, nr. pasurie 9/210, vol.15 fq. 142 me sipërfaqe totale 98.2 m², Kavajë.**

2.2. Adresa e postës elektronike për komunikimin elektronik është: mensurzachev@gmail.com.

2.3. Asambleja e Përgjithshme mund të vendose mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjeter. Organi administrtues i Shoqërisë mund të themelojë ose mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi, brënda apo jashtë Republikës së Shqipërisë.

**NENI 3
KOHËZGJATJA**

3.1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore me afat të pacaktuar.



Faqe 1 e 7
Akti i Themelimit dhe Statuti i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
“ZACHE TRANS”

NENI 4 OBJEKTI I SHOQËRISË

4.1. Objekti i aktivitetit të shoqërisë tregtare është: *Transport mallrash ndërkombëtare brenda dhe jashtë vendit, përvete dhe përvetë tretë. Tregëtim, shërbim me qera, me drejtues mjeti, për çdo mjet të lëvizshem të lejuar për qarkullim, shërbim taksi, shërbim urban, ndërurban, ndërkombetar, ndërkontinental etj. Tregti, import - export me shumicë dhe pakicë të çdo lloj malli të parashikuar në tabelat doganore të Republikës së Shqipërisë.*

4.2. Ortaku i vetëm ka të drejtë të përcaktojë modalitetet për zgjerimin apo zvogëlimin e fushës së aktivitetit të kryer. Veç sa më sipër, në shoqëri do të zhvillohet çdo aktivitet tjetër që vetëm ose së bashku me veprimtarinë kryesore të lartpërmendur, do të vlerësohen si të favorshme për zhvillimin, forcimin dhe rritjen e gjendjes ekonomike e financiare.

4.3. Shoqëria tregtare mund të ndryshojë emërtimin, vendqëndrimin dhe objektin e veprimtarisë së saj sipas vendimeve që do të marrë Asambleja e Përgjithshme.

4.4. Shoqëria zbaton ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*”, të ndryshuar, për ushtrimin e veprimtarisë të saj.

NENI 5 VULA, LOGO E SHOQËRISË DHE LLOGARITË BANKARE

5.1. Shoqëria ka vulën e saj dhe logon e saj, me mbishkrinin e emrit të shoqërisë: “**ZACHE TRANS**”.

5.2. Ajo ka llogarinë e saj bankare në lekë e valuta të tjera në Bankat e nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë ose jashtë Republikës së Shqipërisë.

KREU II

KAPITALI, KALIMI I KUOTAVE, ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

NENI 6 KAPITALI I SHOQËRISË

6.1 Kapitali themelor i shoqërisë është i barabartë me shumën 10.000,00 lekë (dhjetëmijë lekë) dhe përbëhet nga 1 kuotë me vlerë nominale 10.000,00 lekë, që përfaqëson 100% të kuotave të kapitalit, e zotëruar nga ortaku i vetëm **Z. Mensur Zachev**.

6.2. Kapitali themelor i takon ortakut të shoqërisë.

Faqe 2 e 7

*Akti i Themelimit dhe Statuti i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
“ZACHE TRANS”*



NENI 7 TRANSFERIMI I KAPITALIT

- 7.1. Kuotat e kapitalit tē një shoqërie me përgjegjësi tē kufizuar e tē drejtat që rrjedhin prej tyre mund tē fitohen apo kalohen nëpërmjet:
- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashëgimisë;
 - ç) dhurimit;
 - d) çdo mënyre tjetër tē parashikuar me ligj.

Pjesë tē kapitalit themeltar janë lirisht tē transferueshme ndërmjet ortakëve, përsa nuk parashikohet ndryshe në statut. Pjesë tē kapitalit themeltar janë lirisht tē transferueshme në rrugë trashëgimie.

NENI 8 ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

8.1. Kapitali i shoqërisë mund tē zmadhohet ose zvogëlohet në çdo moment me vendim të organeve drejtuese tē shoqërisë, në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqërítë tregtare”, tē ndryshuar.

8.2. Në çdo rast kapitali i regjistruar nuk mund tē zvogëlohet nën kufirin minimal tē parashikuar nga ligji.

8.3. Në asnjë rast shumica nuk mund tē detyrojë një ortak pér tē rritur detyrimin e tij në kapitalin themelor. Pjesët e kapitalit themelor janë lirisht tē transferueshme prej trashëgimtarëve tē çdo ortaku në rast vdekjeje.

KREU III

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

NENI 9 ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

9.1. Organi më i lartë i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme, ajo përbëhet prej ortakut tē shoqërisë. Asambleja është organi sovran i shoqërisë duke u mbështetur në tē drejtën e tyre tē pronësisë private mbi mjetet e investuara në shoqëri.

9.2. Asambleja zhvillon mbledhje tē zakonshme dhe tē jashtëzakonshme. Ajo thirret jo më pak se dy herë në vit. Në mbledhje tē jashtëzakonshme shqyrtohen dhe vendosen probleme që kanë tē bëjnë me krijimin, bashkimin, ndarjen, shpërndarjen, ndryshimin e statutit e probleme tē tjera tē rëndësishme pér tē cilat kërkohet miratimi i përbashkët nga ortakët themelues.

9.3. Asambleja e Përgjithshme përcakton dhe miraton tē drejtat dhe detyrat e organeve tē saj. Të zgjedhurat dhe tē emëruarit nga Asambleja veprojnë në përputhje me dispozitat e këtij statuti, aktit tē themelimit si dhe ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Vendimet që merr Asambleja sipas

Faqe 3 e 7

Akti i Themelimit dhe Statuti i shoqërisë me përgjegjësi tē kufizuar
“ZACHE TRANS”

këtij statuti dhe legjislacionit në fuqi janë të detyrueshme për çdo ortak. Secili ortak ka të drejtë vote sipas përqindjes në kuotën e kapitalit themelues të shoqërisë.

9.4. Secili ortak që ka të drejtën e pjesëmarrjes së Asamble, mund të përfaqësohet në të edhe nga një person tjetër i autorizuar e shkrim nga ortaku i shoqërisë.

9.5. Të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm, për sa kohë shoqëria ka vetëm një ortak.

9.6. Vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për: a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve; c) investime; ç) vendimet përiorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

9.7. Çdo vendim i ortakut të vetëm që është i paregjistruar në regjistrin e vendimeve do të konsiderohet absolutisht i pavlefshëm.

9.8. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmérinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmérinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

9.9. Nëse shoqërisë i shtohen ortakë të tjetër përveç themeluesit, që është në cilësinë e ortakut të vetëm, atëherë asambleja e përgjithshme do të thirret, mblidhet dhe vendosë në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 “*Për tregtarët dhe shoqërítë tregtarë*”, të ndryshuar.

NENI 10 ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

10.1. Shoqëria do të përfaqësohet nga një administrator i vetëm, **Z. Mensur Zachev**, atësia Myrteza, amësia Nabije, shtetas maqedonas, i datëlindjes 21.12.1961, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pajisur me letërnjoftimin nr. M0820958 dhe nr. personal 2112961430003, i zgjedhur nga ortaku i vetëm, për një periudhë maksimale prej 5 (pesë) vjetësh, deri më datë **04.12.2029**. Administratori i vetëm mund të rizgjidhet ose shkarkohet nga asambleja e përgjithshme.

10.2. Administratori i vetëm gjzon të drejta të plota në lidhje me administrimin e shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm. Ai mban përgjegjësi për veprimet e kryera gjatë administrimit të shoqërisë dhe mund të delegojë të tretë për të kryer veprime dhe akte të caktuara, në emër dhe për llogari të shoqërisë.

10.3. Administratori i vetëm vepron në respektim të politikave tregtare të përcaktuara nga asambleja e përgjithshme. Ai është përgjegjës për veprimet e kryera gjatë administrimit të shoqërisë, si dhe duhet të veprojë në çdo kohë vetëm në interesin më të mirë të shoqërisë.

10.4. Shpërblimi i administratorit të vetëm përcaktohet nga ortaku i vetëm.

10.5. Çështjet e punësimit dhe marrëdhënies së punës së administratorit të vetëm rregullohet nga legjislacionin në fuqi për marrëdhëniet e punës, si dhe për sigurimet shoqërore e shëndetësore.

NENI 11 EMËRIMI I ORGANEVE OSE PERSONAVE TË TRETE

11.1. Sipas nevojave që paraqiten për zhvillimin e veprimtarisë ekonomike të shoqërisë, Asambleja emëron organe kontrolli si dhe punëson persona të tjerë të cilët qëndrojnë në detyrë deri sa të

Faqë 4 e 7

Akti i Themelimit dhe Statuti i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
“ZACHE TRANS”

Z. Mensur

kërkohet nga Asambleja ose largohen me dëshirën e tyre.

11.2. Administratorit me përjashtim të rastit kur është ortak i vetëm dhe administrator, nuk i lejohet të kontrakojë në çfarëdo forme qoftë të marrë hua në shoqëri të tjera, të japë pëlqimin në emër të shoqërisë për paradhënie e të bëhet dorëzanës apo të garantojë në emër të saj ndaj të tretëve.

NENI 12 DETYRAT E ADMINISTRATORIT

12.1. Administratori merret me drejtimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë pa kufizime.

12.2. Administratori ka për detyrë të njoftojë e të japë llogari në Asamblenë e Ortakëve me përjashtim të rastit kur është ortak i vetëm dhe administrator dhe si i tillë i mbart vetë këto cilësi.

NENI 13 SHPËRBLIMI I ADMINISTRATORIT

13.1. Asambleja e Përgjithshme përcakton shpërblimin e Administratorit të Shoqërisë.

NENI 14 PËRFUNDIMI I DETYRËS SË ADMINISTRATORIT

14.1. Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

- (a) i përfundon mandati;
- (b) shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme;
- (c) jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar Shoqërinë;
- (d) pësoni nuk gjëzon cilësinë e Administratorit sipas parashikimeve të ligjit;
- (e) mungon pa arsyë në detyrë për më shumë së 6 (gjashtë) muaj radhazi dhe Asambleja e Përgjithshme vendos ta shkarkoje nga detyra

KREU V

KONTROLI FINANCIAR I SHOQËRISË, VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR DHE DIVIDENDI, RUAJTJA E DOKUMENTACIONIT

NENI 15 KONTROLI FINANCIAR

15.1. Kontrolli financiar i Shoqërisë kryhet në përputhje dhe sipas legjisacionit shqiptar në fuqi. Asambleja e Përgjithshme do të emërojë një apo më shumë Ekspert Kontabël të Autorizuar në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit.

Z. Nezry
Faqe 5 e 7
Akti i Themelimit dhe Statuti i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
“ZACHE TRANS”

NENI 16 VITI FINANCIAR

- 16.1. Viti finansiar i shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti, me përjashtim të vitit të parë të aktivitetit të shoqërisë, i cili fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë dhe mbylljet në fund të këtij viti.
- 16.2. Si rregull veprimet ekonomike të Shoqërisë mbyllen më 31 Dhjetor të çdo viti, përjashtim nga ky rregull do të bëhet kur kërkon organi kompetent ligjor.
- 16.3. Veprimtaritë ekonomike dhe financiare të shoqërisë mbyllen më datë 31 Dhjetor të çdo viti. Administratori i shoqërisë nxjerr bilancin kontabël dhe raportin përkatës në përputhje me dispozitën ligjore dhe kontabilitetin.
- 16.4. Raporti i administrimit, inventaret, bilancet dhe llogaritë vjetore të hartuara i nënshtrohen pa përjashtim miratimit nga Asambleja e ortakëve (ortaku i vetëm) brenda afateve të caktuara.
- 16.5. Me miratimin e bilancit kontabël shoqëria vendos përfondet e nevojshme për zhvillimin, si p.sh fondi rezervë, akte të akumulimit, investimit, etj.

NENI 17 BILANCI VJETOR DHE DIVIDENDI

- 17.1. Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, raportet e organit të administrimit dhe të audituesit ligjor (nëse është emëruar) miratohen nga ortaku i vetëm.
- 17.2. Dokumentet që kanë të bëjnë me vitin finansiar miratohen nga ortaku i vetëm brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit finansiar.
- 17.3. Ortaku i vetëm vendos mbi shpërndarjen e dividentit në bazë të rezultatit finansiar të shoqërisë, sipas parashikimet të legjisacionit në fuqi.
- 17.4. Të ardhurat neto pas veçimit të fondeve si më sipër dhe shlyerjes së detyrimeve fiskale i mbresin përfedorim ortakëve të shoqërisë të cilët i ndajnë midis tyre në përputhje me kuotat e secilit në formimin e kapitalit themelor të shoqërisë përcaktuar sipas parashikimeve të aktit të themelimit.
- 17.5. Çdo ortak ka të drejtën e transferimit jashtë vendit të pjesës së fitimit duke zbatuar dispozitat ligjore për këtë.
- 17.6. Asambleja e ortakëve mund të vendosë që të shpërndahen shumat e fondeve të rezervuara duke treguar shprehimisht llojin e rezervës ku janë marrë.

NENI 18 RUAJTJA E DOKUMENTACIONIT

- 18.1. Në selinë e shoqërisë tregtare mbahet dokumentacioni i plotë i saj, mbahen protokollet e ndryshme, dokumentacioni i kontabilitetit ku mund të bëhet vetëkontroll ose përfundimtari i njohës mirë nga ortakët

Faqe 6 e 7
Akti i Themelimit dhe Statuti i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
"ZACHE TRANS"

KREU VI
PRISHJA DHE LIKUIDIMI, LIGJI I ZBATUESHEM,
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

NENI 19
PRISHJA DHE LIUIDIMI I SHOQËRISË

19.1. Në rastin e prishjes dhe likuidimit të Shoqërisë do të zbatohen dispozitat e parashikuara në ligjin për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare.

NENI 20
LIGJI I ZBATUESHËM

20.1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Akt Themelimi e Statut dhe ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë akt, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar në fushen e shoqërive tregtare.

NENI 21
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

21.1. Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Shoqërisë dhe ortakëve, apo ndërmjet ortakëve dhe trashëgimtarëve të ortakëve ose ortakëve të tjera dhe/ose Shoqërisë, që kanë për objekt të drejta të lidhura me Shoqërinë, do të zgjidhen miqësish ndërmjet palëve të intëresuara. Në rast së palët nuk arrijnë një zgjidhje miqësore, Gjykata do të jetë kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Ky Akt Themelimi dhe Statut hartohet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe.

**ORTAKU THEMELUES I STATUTIT
TË SHOQËRISË MË PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ZACHE TRANS”**

**Përfaqësuar nga Ortak i Vetëm
MENSUR ZACHEV**


(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)